



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.20.1-2017-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Liridona Berisha- Kelmendi (udhëheqëse ekipi), dhe Laureta Matoshi Pozhegu, Mjellma Dibra Morina, Mimoza Morina Kelani (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
5 Qeverisja e mirë.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	19
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	22
Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	25
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 26/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Këshillit Prokurorial të Kosovës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit-2017

Menaxhmentit ka marrë në konsideratë dhe nuk është pajtuar me të gjeturat të detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet për të cilat janë pajtuar pjesërisht apo nuk janë pajtuar mund t'i gjeni në shtojcën III.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e organizatës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Zyrtari kryesor financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur

përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Sekretariatit të KPK është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga KPK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të cilësisë së PFV-ve dhe kërkesave për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KPK-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, është e saktë dhe e drejtë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KPK në përgjithësi ka kontrolle të duhura në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera. Megjithatë, nevojiten përmirësime në menaxhimin e pagave dhe shtesave, menaxhimin e personelit, si dhe menaxhimin e pasurive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,483,682	9,104,443	8,184,785	7,669,086	7,034,306
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,483,682	9,104,443	8,184,785	7,669,086	7,034,306

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 379,239€. Ky zvogëlim është rezultat i shkurtimeve buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale me rishikim të buxhetit.

Në vitin 2017, KPK ka shpenzuar 8,184,785€ apo 90% të buxhetit final me një zvogëlim prej 6% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,483,682	9,104,443	8,184,785	7,669,086	7,034,306
Pagat dhe Mëditjet	6,600,000	6,300,000	6,049,601	5,616,146	5,169,452
Mallrat dhe Shërbimet	1,426,552	2,138,313	1,959,287	1,928,355	1,600,916
Shërbimet komunale	199,630	176,630	100,206	103,833	131,945
Investimet Kapitale	1,257,500	489,500	75,691	20,752	131,993

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 300,000€, ky zvogëlim ishte me rishikim të buxhetit² si rezultat i mos plotësimit të 45 vendeve të punës të ndara me marrëveshjen e Brukselit për të gjitha prokuroritë, (13 prokuror dhe 32 nëpunës administrativ). Realizimi i buxhetit ishte 96%;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 711,761€, kjo rritje ishte me rishikim të buxhetit dhe me vendimet e Qeverisë³. Rritja e buxhetit ishte për mbulimin e pagesës së qirasë si dhe materialit për ngrohje të objektit në Prokurorinë Themelore Mitrovicë (përbushja e obligimit nga marrëveshja e Brukselit), si dhe për pagesat e obligimeve të avokatëve, ekspertëve dhe ndërmjetësuesve. Realizimi i buxhetit ishte 92%;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte reduktuar për 23,000€. Kjo shumë ishte alokuar për mallra dhe shërbime. Realizimi i buxhetit ishte vetëm 57% për arsye se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës e cila ndanë objektin me EULEX-in, si dhe Prokuroria e Apelit dhe Themelorja janë të vendosura në objektin e pallatit të drejtësisë në Prishtinë, prandaj shërbimet komunale janë përgjegjësi e MAP-it; dhe
- Buxheti final për investimet kapitale ishte zvogëluar për 768,000€. Me rishikim të buxhetit për dy projekte ishin marrë plotësisht mjetet financiare ('Ndërtimi i objektit të ri për KPK-në dhe Prokurorinë e Shtetit' në vlerë 685,000€ dhe 'Pajisje të teknologjisë informative' në vlerë 15,000€). Për katër projektet tjera mjetet financiare ishin marrë pjesërisht (80%-47%), për projektet „Salla për konferenca (28,000€)”, „Blerja e fotokopjeve (24,000€)”, „Sistemi elektronik i dosjeve(8,000€)” dhe „Sistemi elektronik i veturave (8,000€)”. Edhe përkundër zvogëlimit të buxhetit final, realizimi i buxhetit ishte në nivel shumë të ulët (15%).

² Ligjit Nr.06/L-002 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.05/L-125 për Buxhetin e R.K për vitin 2017.

³ Vendimin Nr.04/14 të datës 15 nëntor 2017 dhe Nr.10/19 të datës 15 dhjetor 2017.

Çështja 1 - Ekzekutimi i buxhetit për investime kapitale

- E gjetura** Shpenzimi i buxhetit nxjerr në pah një nivel relativisht të ultë të ekzekutimit të buxhetit për investimet kapitale vetëm 15% gjatë vitit 2017. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk ishin analizuar në baza të rregullta ecuritë buxhetore në realizimin me kohë të projekteve kapitale si dhe për shkak të ngecjeve në inicimin e kërkesave dhe procedurave të prokurimit që kanë të bëjnë me projektet si „Sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve (SMIL) në bashkëfinancim me Qeverinë Norvegjeze dhe „Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Veturave SEMV”
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i realizimit të projekteve, ka ndikuar në mos arritjen e objektivave të organizatës me ecuritë e shpenzimeve për projektet kapitale.
- Rekomandimi 1** Drejtori i SKPK duhet të sigurojë që me rastin e planifikimeve buxhetore të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës të burimeve potenciale (mjeteve financiare) dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit në investime kapitale.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrolllet kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative.

Numri i aprovuar i të punësuarave në KPK ishte 698, ndërsa numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 659⁴ punonjës. Ne kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës. Nga testimet tona identifikuam çështjet si në vijim:

⁴ Për shkak se 39 pozita të aprovuara ende nuk ishin të plotësuara.

Çështja 2 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre

- E gjetura** Neni 30 i LSHC nr.03L/149, përcakton se në rast të mbajtjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (U.D) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.
- Gjatë auditimit kemi identifikuar se tre pozita mbulohen me Ushtrues Detyre (UD) duke tejkeluar afatin e lejuar për mbajtjen e pozitës. Rastet janë: *Menaxhere e zyrës për komunikim publik* në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit mbulohet me UD nga dt. 03.02.2017 (KPK një herë kishte shpallur konkursin), *Udhëheqës i departamentit për teknologji informative* në Sekretariatit e KPK-së mbulohet me UD nga dt. 04.04.2017 (KPK kishte shpallur tri herë konkursin), si dhe *Udhëheqës i zyrës për transport* në Sekretariatit e KPK-së mbulohet me UD nga dt. 04.04.2017.
- Rreziku** Praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore, përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.
- Rekomandimi 2** Drejtori i SKPK-së duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e procedurave të rekrutimit që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja në pozitën si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

3.3 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet tona identifikuam çështjet në vijim:

Çështja 3 - Mangësi në procesin e avancimit

- E gjetura** Rregullorja nr.21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civil, përcakton që shpallja për avancim së pari të bëhet brenda njësisë së institucionit, dhe nëse në pozitën e lirë aplikojnë më pak se tre kandidatë që plotësojnë kriteret, njësia e personelit shpall konkurs në nivel të institucionit.
- Gjatë auditimit ne kemi identifikuar se në tri shpalljet e brendshme për avancim të stafit për pozitën udhëheqëse, si: *Udhëheqës për buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme, Udhëheqës për burime njerëzore dhe Udhëheqës i prokurimit*, nuk është bërë shpallja së pari brenda njësisë përkatëse, por në tërë Sekretariatit e Këshillit Prokurorial.
- Rreziku** Mos aplikimi i kriterëve në shpalljen e konkurseve nga KPK-ja, rrit rrezikun që në pozitën e caktuara të rekrutohen personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme, për më tepër mund të rezultojë me reduktim të performancës së punonjësve dhe organizatës në përgjithësi.
- Rekomandimi 3** Drejtori i SKPK duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme që zhvillimi i procedurave për avancime dhe rekrutime të ju përmbahen kërkesave rregullative në fuqi.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 2,314,943€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,059,493€. Vonesat në nxjerrjen e urdhër blerjeve ishin adresuar nga KPK. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzimet për furnizim për zyre, naftë për ngrohje qendrore, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve etj. Në mostrat e ekzaminuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 489,500€, i cili ishte shpenzuar 75,691€. Shpenzimet kishin të bëjnë me projektet, si furnizim me aparate fotokopjuese, sistemi elektronik për menaxhimin e dosjeve dhe sistemi elektronik për menaxhimin e veturave. Në mostrat e ekzaminuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria jo financiare kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PVF ishte në vlerë 3,459,310€, pasuria jo-kapitale nën 1,000€ ishin në vlerën 252,974€, ndërsa stoqet 90,031€.

Ne testuam blerjet e vitit 2017, rregullsinë në regjistrimin e pasurisë, si edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurive. Dobësitë janë të theksuara më poshtë.

Çështja 4 - Menaxhimi i pasurive

E gjetura KPK kishte themeluar komisionin e inventarizimit të pasurive të shoqëruar me raporte përkatëse për inventarizim. Ne identifikuam se raportet e inventarizimit të prokurorive kishin evidentuar pasuri që janë jo funksionale (jashtë përdorimit) dhe pasuri me vlerë zero, por të njëjtat pasuri figurojnë në regjistrat e pasurive. KPK nuk kishte themeluar komisionin për vlerësimin e pasurive në mënyrë që i njëjti të evidentonte pasurit që duhen të largohen nga përdorimi ose të tjetërsohen, siç kërkohet me rregulloren MF. nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë financiare.

Rreziku Mos themelimi i komisionit për vlerësimin e pasurisë si kërkesë rregullative, ndikon që pasuria e KPK-së të mbivlerësohet, dhe se kjo mund të rezultojë me prezantim jo të plotë dhe të saktë të pasurive në PVF.

Rekomandimi 4 Drejtori i SKPK duhet të siguroj që është themeluar komisioni i vlerësimit i cili duhet të bëjë vlerësimin e të gjitha pasurive që ka KPK-ja, duke përgatitur një raport mbi gjendjen e pasurive, dhe i njëjti të harmonizohet me regjistrat kontabël, në mënyrë që vlera e pasurive në PVF të jetë e plotë dhe e saktë.

3.7 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 230,620€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Arsyeja e mos pagesës ishte mungesa e mjeteve financiare. Krahasuar me vitin 2016 vërehet një rënie e obligimeve të papaguara për 65,131€ apo 22%.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 ka rezultuar me dhjetë rekomandime. KPK kishte përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit dhe kishte paraqitur mënyrën se si do t'i zbatohen rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2017, shtatë rekomandime ishin zbatuar, një ishte në proces të zbatimit dhe dy nuk ishte zbatuar ende.

Për më tepër, nga viti 2015 ishin bartur tetë rekomandime, gjashtë rekomandim ishte zbatuar dhe dy ishin në proces e sipër të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 5 - Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake

E gjetura KPK ka bërë progres në zbatimin e rekomandimeve, megjithatë mos zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve ka ndikuar që disa mangësi të përsëriten nga viti i kaluar. Kjo ishte e theksuar kryesisht të:

- Procedimi i pagesave për kujdestari; dhe
- Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.

Rekomandimi 5 Drejtori i SKPK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar për adresimin e rekomandimeve të mbetura. Ky plan duhet të përcaktoj afatet e arsyeshme kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e plotë të rekomandimeve.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisja e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

KPK në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. KPK ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve, si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), përbëhet nga Drejtor i NJAB. NJAB kishte të aprovuar planin vjetor dhe strategjik. NJAB për vitin 2017 kishte planifikuar dhe kryer pesë auditime të rregullta. Auditimet e kryera nga NJAB mbulojnë departamentet si të financave, të administratës dhe burimeve njerëzore.

KPK kishte të themeluar komitetin e auditimit i cili përbëhet prej tre anëtarëve. Komiteti kishte mbajtur katër takime ku ishin diskutuar çështjet që kishin dalë nga NJAB dhe nga auditimi i jashtëm.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Procesi i raportimit të brendshëm në KPK-së funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak.	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimt, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		KPK nuk kishte bërë monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.	
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale.	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë. Regjistrimi i tyre duhet të bëhet (të përmbajnë të gjitha elementet) në përputhje me legjislacionin. Zhvlerësimi duhet të bëhet në përputhje me normat e përcaktuara, dhe në PVF të prezantohet vlera neto e pasurisë. Ndërsa në fund të çdo viti pas procesit të inventarizimit, duhet të harmonizohen regjistri i përgjithshëm i pasurisë me regjistrin e nxjerrë në procesin e inventarizimit.		KPK kishte zbatuar në përgjithësi rekomandimet e ZKA por ende ishte në proces gjatë vitit 2018.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim.	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuar në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet për të zhvlerësuar pasurinë bazuar në normat përkatëse të tyre, si dhe për të adresuar problemet që në vazhdimësi po e përcjellin sistemin e pasuria.	Është zbatuar		

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë se është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar. Veprime shtesë të ndërmerren ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit të këtyre rekomandimeve.		Nuk ishte bërë monitorimi i rekomandimeve të ZKA.	
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat për të ofruar informacione të plota rreth funksionimit të sistemit të MFK-së. Pas plotësimit të pyetësit duhet aplikuar një mekanizëm të rishikimit për të konfirmuar saktësinë e të dhënave të prezantuara si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës konform kërkesave.	Është zbatuar		
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë bashkëpunim të ngushtë me NJAB-në dhe KA-në për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm. Derisa KA duhet të avancojë rolin e vet në këtë proces me qëllim të mbajtjes së menaxhmentit më përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.	Është zbatuar		
3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të ndërmerr veprime për të ndërprerë mbulimin e pozitive me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që pozita të plotësohet me kontratë të rregullte sipas përcaktimit ligjor.			Nuk është zbatuar. Për me tepër nuk kanë ndërmarr asnjë masë për adresimin e tyre.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë se vendimet për kompensime për punë jashtë orarit të jetë në harmoni me rregullat e përgjithshme dhe parimet e Ligjit të punës dhe Ligjit për pagat e nëpunësve civil, për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera.			Nuk është zbatuar. Për me tepër nuk kanë ndërmarr asnjë masë për adresimin e tyre.
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë që blerjet bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet, respektivisht çdo furnizimi t'i paraprijë zotimi dhe urdhër blerja. Furnizimet dhe procesimi i pagesave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPF-në dhe më rregullat e Thesarit.	Është zbatuar.		
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit/pagesave me qëllim që çdo faturë të paguhet në afatin e paraparë ligjor.	Është zbatuar.		
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë që çdo vendim dhe rregullore e brendshme të hartohet në harmoni me ligjet bazike, siç është LMFPF dhe ligji për të ardhurat personale, duke shmangur shpenzime dhe pagesa të jashtëligjshme.	Është zbatuar.		
3.3 Obligimet e papaguara	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë kontrole shtesë sa i përket raportimit të saktë dhe me kohë të obligimeve. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore.	Është zbatuar.		

Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtit ⁵	Pikëpamja e ZKA-së
Çështja 1: Ekzekutimi i buxhetit për investime kapitale	Pjesërisht	<p>Komenti i të gjeturës "kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk ka analizuar në baza të rregullta ecuritë buxhetore në realizimin me kohë të projekteve kapitale si dhe për shkak të ngecjeve në inidmin e kërkesave dhe procedurave të prokurimit që kanë të bëjnë me projektet si „Sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve (SMIL) në bashkëfinancim me Qeverinë Norvegjeze dhe „Mjetet e transportit", nuk qëndron meqë menaxhmenti ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar projektet e planifikuara, por kjo është pamundësuar edhe nga faktor të jashtëm, siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngrirja e projekteve kapitale sipas vendimit (që e gjeni të bashkangjitur) deri në proces të rishikimit që ka përfunduar me marrjen e mjeteve në kapitale; • Mos ndarja e hapësirës për ndërtim të objektit të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit apo për kalimin e pronësisë të objektit ku aktualisht janë të vendosura këto institucione, përkundër përpjekjeve të bëra në takime nga Këshilli me zyrtarët e institucioneve përgjegjëse; • Ndalimi i blerjes së veturave dhe vonesat në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AQP kanë pamundësuar projektin kapital "Mjetet e transportit" ku AQP nuk ka zhvilluar procedura të blerjes së veturave me arsyetirnin se projekte të tilla janë ndaluar nga Qeveria me qellim që veturat e nevojshme për OB të merren me qira. 	<p>KPK është pajtuar me përmbajtje e të gjeturës. KPK nuk ka ofruar dëshmi, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pa ndryshuar.</p>

⁵ Për korrekësi nuk kemi ndërhy në komentet e KPK-së

<p>Çështja 2: Mbulimi i pozitivave me Ushtrues Detyre</p>	<p>Jo</p>	<p>Si rezultat i ndryshimeve ligjore të përcaktuara me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin, Sekretariati i Këshillit ka pësuar një reformim strukturor dhe përmbajtësor. Në kuadër të këtij ndryshimi përfshihen edhe pozitave të cilat është dashur të mbulohen me UD deri në rekrutim të pozitivave. Ka qenë një ndër sfidat kryesore të Këshillit që të gjitha pozitave të mbulohen me kohë dhe për këtë arsye bazuar edhe në rekomandimin e auditorit është përcaktuar si prioritet për BNJ shpallja e të gjitha pozitivave përfshirë edhe pozitave që mbulohen me UD. Menaxheri i zyrës për Komunikim me Publikun është shpallur dy herë brenda vitit 2017 dhe në nëntor të vitit 2017 është plotësuar pozita, ndërsa pozitave për Udhëheqës të Departamentit për TI është shpallur me 25 gusht 2017 dhe rishpallur edhe dy herë tjera. Për pozitave tjera procesi ka vazhduar edhe në vitin 2018 e shumica prej tyre tanimë janë të plotësuar apo janë në proces përfundimtar të plotësimit.</p>	<p>Menaxhere e zyrës për komunikim publik mbulohet me U.D nga data 03.02.2017 vazhdon tutje, Udhëheqës i departamentit për teknologji informative në Sekretariatit e KPK-së mbulohet me UD nga dt. 04.04.2017 vazhdon tutje si dhe Udhëheqësi i zyrës për transport në Sekretariatit e KPK-së mbulohet me UD nga dt. 04.04.2017 vazhdon tutje. KPK nuk ka ofruar dëshmi, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pa ndryshuar.</p>
<p>Çështja 3: Mangësi në procesin e avancimit</p>	<p>Jo</p>	<p>Këshilli është institucion kushtetues dhe i pavarur ka strukturë të veçantë organizative. Këshilli ka pubhkuar konkurset e brendshme brenda institucionit sepse të gjitha shërbimet e personelit buxhetit, financave, shërbime të përgjithshme dhe prokurimit janë shërbime të centralizuar dhe në shërbim për gjithë sisternin prokurorial. Duke respektuar parimet e përgjithshme të shërbimit civil edhe tek rasti i avancimit, përkatësisht konkursi është shpallur i brendshëm dhe pastaj i jashtëm. Të gjitha pozitave janë aprovuar nga MAP-i dhe monitoruar nga KPM. Një rekomandim të tillë nuk e kemi pas as nga MAP-i dhe as nga KPM.</p>	<p>Sipas strukturës organizative mbi organizimin e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës janë të ndarë tri departamente, ku secili departament është i ndarë në Divizione. Departamenti për burime njerëzore, prokurim dhe administratë, përbëhet nga: Divizioni për burime njerëzore, Divizioni për prokurim dhe Divizioni për Administratë(zyra për përkthim dhe lektorim dhe zyra për administrimin dhe arkivimin e dokumenteve).. Në secilën departament, divizion janë të punësuar numëri i mjaftueshëm i stafit për të aplikuar në përputhe të nenit 5 të Rregullës nr. 21/2012⁶. KPK nuk ka ofruar dëshmi, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pa ndryshuar.</p>

⁶ Për avancim në karrierë të nënpunësve civilë.

<p>Çështja 4: Menaxhimi i pasurive</p>	<p>Jo</p>	<p>Këshilli gjatë vitit 2017 e ka kryer një proces të vlerësimit sipas nevojës.</p> <p>Në bazë të raportit të inventarizimit dhe kërkesave për tjetërsim Këshilli ka filluar një proces të ri të vlerësimit ku me 02 maj 2018 është caktuar Komisioni për Vlerësim të Pasurisë jo financiare të Këshillit. Komisioni është në proces e sipër të vlerësimit të pasurisë konform Rregullores së MF-së Nr. 02/2013.</p> <p>Për më tepër, pasuria që është jashtë funksioni dhe pa vlerë të mbetur nuk e mbivlerëson pasurinë në asnjë mënyrë.</p>	<p>KPK nuk kishte të themeluar komisionin për vlerësimin e pasurisë për periudhën audituese për ti vlerësuar pasuritë nga raporti i komisionit të inventarizimit. Në bazë të Rregullorës 02/2013⁷, pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurirë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare. KPK nuk ka ofruar dëshmi, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pa ndryshuar.</p>
<p>Çështja 5: Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake</p>	<p>Jo</p>	<p>Gjatë vitit 2017, me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së, Këshilli ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin i cili ka ndaluar pagesat për stafin administrativ me përjashtim të kujdestarisë për shkak të efektit financiar.</p> <p>Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre është komentuar në të gjeturën e dytë.</p>	<p>KPK është pajtuar me përmbajtje e të gjeturës, pjesërisht rekomandimi është zbatuar mbetet edhe pjesa tjetër të zbatohet.</p> <p>KPK nuk ka ofruar dëshmi për pjesën tjetër, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pa ndryshuar.</p>

⁷ Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic Of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:

Prishtinë, 07.06.2018

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të KPK-së për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- nuk pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe të bashkangjitur me këtë letër konfirmimi i gjeni komentet për përmbajtjen e Raportit si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës:

Lavdim Krasniqi